



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština – Municipality of Prishtina**



---

## **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 25.5.2023, e cila filloi në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Rashit Gashi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Radie Hoxhaj, (LVV), Berna Saraçi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (LDK), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

**Munguan:** Trieria Kasumi-Berisha (LVV), Berat Lahu (LVV), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK) dhe Agim Kuleta (LB).

**Të pranishëm ishin edhe:** Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës, Donjeta Sahatçiu, nënkryetare e Komunës, Bersant Beka, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Besianë Musmurati, drejtore e Drejtorisë së Arsimit, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe përfaqësues të OJQ-ve.

---

### **Faqe 1 nga 12**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit.  
Kryesuesi hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës.

**Izet Sadiku**, drejtor, propozoi që në rend të ditës të futet pika "Propozimi i projektstatutit të poliklinikës stomatologjike".

**Adelina Sahiti**, drejtore, propozoi që në rend të ditës të futet pika "Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për dy familje strehuese, të cilat përkujdesen për dy fëmijë me aftësi të kufizuara pa përkujdesje prindërore dhe familjare".

**Besianë Musmurati**, drejtore, propozoi që në rend të ditës të futet pika "Propozimvendimi për subvencionimin e familjeve për regjistrim të fëmijëve në institucionet parashkollore private".

**Endrit Zabërgja** kërkoi nga kryetari që për mbledhjen e radhës, si pikë e rendit të ditës të jetë: "Diskutim për rininë", pasi që kjo temë veç është e paraparë edhe në Planin e punës së Kuvendit.

**Arianit Beqiri** kërkoi që në rend dite të futet edhe pika "Informatë për procesin e mbarëvajtjes së zgjedhjeve për këshillat e bashkësive lokale".

**Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e dhëna.**

**Kryesuesi** konstatoi se më 35 vota për dhe 3 kundër, "Propozimi i projektstatutit të poliklinikës stomatologjike" futet në rend të ditës për diskutim.

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri, më 43 vota për, " Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për dy familje strehuese, të cilat përkujdesen për dy fëmijë me aftësi të kufizuara pa përkujdesje prindërore dhe familjare", futet në rend të ditës për diskutim.

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri, më 42 vota për, " Propozimvendimi për subvencionimin e familjeve për regjistrim të fëmijëve në institucionet parashkollore private", futet në rend të ditës për diskutim.

**Kryesuesi** konstatoi se më 39 vota për dhe 3 abstenime "Informata për procesin e mbarëvajtjes së zgjedhjeve për këshillat e bashkësive lokale" futet në rend të ditës për diskutim.

**Gëzim Sveçla** tha se, pikat të cilat janë të propozuara nga Drejtoria e Sportit, që kanë të bëjnë me subvencionet, për shkak të kohës, propozoj që diskutimi të bëhet i përbashkët, ndërsa votimi i tyre të jetë ndaras për secilën pikë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 43 vota për u miratua ky

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të volejbollit "Prishtina" - femrat;
3. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të basketbollit "Sigal Prishtina";
4. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të basketbollit të femrave "Prishtina";
5. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të futsalit – FC "Prishtina Futsal 01";
6. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të hendbollit - femrat KHF "Prishtina 1957";
7. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të hendbollit "Prishtina" - meshkujt";
8. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të volejbollit "Prishtina";
9. Propozimi i projekt statutit të poliklinikës stomatologjike;
10. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për dy familje strehuese, të cilat përkujdesen për dy fëmijë me aftësi të kufizuara pa përkujdesje prindërore dhe familjare;
11. Propozimvendimi për subvencionimin e familjeve për regjistrim të fëmijëve në institucionet parashkollore private;
12. Informatë për procesin e mbajtjes së zgjedhjeve të Këshillave të Bashkësive Lokale;
13. Raporti vjetor i punës për vitin 2022 i ndërmarrjes publike "Kuzhina Qendrore", SHA;
14. Raporti vjetor i punës për vitin 2022 i ndërmarrjes publike " Prishtina Parking", SHA;
15. Raporti vjetor i punës për vitin 2022 i ndërmarrjes publike "Hortikultura", SHA;
16. Pyetje dhe Përgjigje;
17. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Kryeqytetit.

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Kryeqytetit.

Pika e dytë, pika e tretë, pika e katërt, pika e pestë, pika e gjashtë, pika e shtatë dhe pika e tetë.

**Gëzim Sveçla**, ngriti shqetësim rreth subvencionimit të këtyre klubeve sportive, duke thënë se pikërisht statusi juridik që e posedojnë, pra të qenët OJQ është ajo që i penalizon në raport me subvencionimet e propozuara. Ndarja e subvencioneve për OJQ- të që kalojnë shumën prej 500 euro, bëhet në bazë të Rregullores së Ministrisë së Financave, nr. 04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, kështu që Rregullorja komunale me automatizëm, përmes nenit 3.3 e bart tek Rregullorja 04/2017 e Ministrisë së Financave. Në këtë rast baza ligjore për subvencionet e propozuara do duhej të ishte në pajtueshmëri me normat juridike që i përmban kjo rregullore.

Jemi të bindur se aprovimi i këtyre propozimeve është i jashtëligjshëm, prandaj sot ne do të krijojmë precedentë për të mirë dhe për ta zbatuar ligjshmërinë, ne si grup parlamentar do të votojmë kundër këtyre propozimeve. Lidhur me këto subvencionime, do të ishte mirë që ta kemi edhe ndonjë interpretim ligjor nga Zyra ligjore apo ndonjë sqarim edhe nga kryetari.

**Pëllumb Bajçinovci** tha se ne si GP i LDK-së e përkrahim vendimin për ndarjen e mjeteve financiare klubeve më të suksesshme të Kryeqytetit, gjysma e të cilave janë edhe kampione të Kosovës, të cilat pretendojnë edhe suksese më të mëdha.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se është mirë që po bëhen këto subvencionime të këtyre klubeve dhe është më se e nevojshme që të motivohen të rinjtë dhe të rejat, dhe si Kryeqytet e kemi obligim sadopak që të japim kontributin tonë, edhe pse ky kontribut nuk i paraprinë të gjitha nevojave që i kanë klubet. Si GP i PDK-së do ta përkrahim subvencionimin e këtyre klubeve sportive.

**Endrit Gashi** në emër të GP të AAK-së përkrahi miratimin e propozimvendimeve pasi që këto klube kanë treguar suksese, andaj kanë nevojë edhe për mbështetje financiare.

**Gëzim Mehmeti** shprehu mendimin se në këtë rast ne po e bëjmë të kundërtën, po u ndihmojmë atyre që janë të suksesshëm, që i kanë dy ekipe, e në realitet nuk po iu ndihmojmë atyre që i stimulojmë të punojnë sa më shumë me të rinjtë.

Andaj, propozoj që më shumë të fokusohemi në rini, prej fatosave deri në junior, ato ekipe të cilat më shumë punojnë me të rinjtë.

**Endrit Zabërgja** tha se ne sot po i votojmë këto subvencione për klubet sportive, por do të ishte mirë që të krijohen mundësitë dhe të subvencionohen klube të tjera, duke pasur parasysh se është e nevojshme që edhe klubet e tjera të marrin shuma të konsiderueshme të mjeteve, në mënyrë që të masivizohet sporti në kryeqytet.

Si asamblist dhe në emër të NISMA-së, pa dyshim se e mbështesim secilin subvencionim të klubeve elitare të kryeqytetit.

**Feim Osmani** ngriti shqetësim, duke thënë se a është në rregull me e marrë një vendim të paligjshëm për me e bërë të ligjshëm, andaj për këtë kërkoi nga ekzekutivi që të japë një sqarim rreth bazës ligjore.

**Ermal Osmani** u shpreh se kërkesa jonë është shumë legjitime, kështu që nuk jemi kundër ekipeve të Prishtinës, por jemi për zbatimin e ligjit.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Përparim Rama, kryetar, dhe Arben Kçira, përfaqësues i Zyrës ligjore.

**Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për dhe 11 kundër, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të volejbollit "Prishtina" - femrat.**

**Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për dhe 14 kundër, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të basketbollit "Sigal Prishtina".**

**Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për dhe 15 kundër, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të basketbollit të femrave "Prishtina".**

**Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për dhe 15 kundër, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të futsalit - FC "Prishtina Futsal 01".**

**Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për dhe 13 kundër, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të hendbollit - femrat KHF "Prishtina 1957".**

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për dhe 15 kundër, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të hendbollit "Prishtina" - meshkujt".**

**Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për dhe 15 kundër, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të volejbollit "Prishtina".**

**Pika e nëntë**

**Propozimi i Projektstatutit të Poliklinikës Stomatologjike.**

Lidhur me propozimin e Projektstatutit të Poliklinikës Stomatologjike, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Izet Sadiku, drejtor.

**Violeta Salihu** tha se ne nuk mund të pranojmë ta votojmë këtë statut, për arsye se nuk është në harmoni me Ligjin për shëndetësi. E dimë se si i tillë nuk do të ketë bazë ligjore që do të mund të implementohet. Përpos aspektit ligjor, ky statut është i papranueshëm edhe për shkak të përmbajtjes së tij. Si GP i LVV-së, kemi vërejtje në disa nga nenet tij, si në nenin 7, nenin 8.2, nenin 18, si dhe nenin 18.1. Si GP nuk do ta votojmë këtë projektstatut.

**Fiknete Bejta** theksoi se ky projektstatut determinon të gjitha elementet ku duhet të bazohet funksionimi i këtij institucioni shëndetësorë, kjo poliklinikë që ofron shërbime sekondare është shumë e rëndësishme për kryeqytetin. Si projektstatut determinon të gjitha elementet e rëndësishme të një poliklinike ose institucioni shëndetësor, duke përfshirë organizimin, hierarkinë menaxheriale, nënshërbimet që do të ofrohen në këtë poliklinikë.

Grupi parlamentar i LDK-së e voton këtë projektstatut të Poliklinikës Stomatologjike.

**Agron Canolli** u shpreh se ne si GP i PDK-së e përkrahim për votim projektstatutin e Poliklinikës Stomatologjike.

**Gëzim Mehmeti** tha se edhe ne jemi për këtë projektstatut, por kisha kërkuar që propozimet të cilat u dhanë nga parafolësit, të harmonizohen paraprakisht dhe pastaj të votohet këtu bashkërisht.

**Nora Kelmendi** theksoi se këtë projektstatut e kam analizuar në secilin nen, në bazë të Ligjit për shëndetësi dhe në bazë të Statutit të Qendrës Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës, prej të cilit është kopjuar ky statut, pra është i ngjashëm me Statutin e Qendrës, në nenet 1.2, nenin 2, nenin 3.2, nenin 7.1, nenin 8, nenin 8.2, nenin 9, nenin 9.4, nenin 10.2, nenin 17, nenin 21,5, dhe nenin 22.1.

**Arianit Beqiri** kërkoi të dijë se a është duke ecur procesi i vizitave sistematike nëpër shkolla tek fëmijët, sepse aty është pjesa kryesore ku gjenden sëmundjet e theksuara, sa është duke u bërë për vetëdijesimin e kujdesit dental, për shkak se, sidomos tek fëmijët, fillon, por pastaj edhe tek të rriturit, se nuk është që i kushtojnë aq shumë rëndësi aspektit dental.

**Gëzim Sveçla** tha se ky projektstatut nuk është në përputhshmëri me ligjet, por nuk është as i kompletuar. Për të qenë ky projektstatut sa më funksional dhe gjithëpërfshirës, vërejtjet të cilat ne i parashtruam të merren dhe të inkorporohen, në mënyrë që ky të jetë një statut i kompletuar.

**Feim Osmani** tha se do të ishte mirë që të merren parasysh të gjitha ato propozime të dhëna nga parafolësit, në mënyrë që të jetë sa më i kompletuar dhe të na silltet në seancën e radhës me këto ndryshime.

*Duke pasur për bazë diskutimet, vërejtët dhe sugjerime e dhëna, Izet Sadiku, drejtor, tha se në seancën e ardhshme do të vijmë me këto propozimet dhe ndryshimet që janë propozuar sot, pastaj të futet si pikë e rëndit të ditës.*

**Kryesuesi** tha se me propozim të Izet Sadikut, drejtor, pika "Propozimi i Projektstatutit të Poliklinikës Stomatologjike hiqet nga rendi i ditës.

#### **Pika e dhjetë**

**Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për dy familje strehuese, të cilat përkujdesen për dy fëmijë me aftësi të kufizuara pa përkujdesje prindërore dhe familjare.**

Arsyeshmërinë për ndarjen e mjeteve për dy familje strehuese, të cilat përkujdesen për dy fëmijë me aftësi të kufizuara pa përkujdesje prindërore dhe familjare, në pika të shkurtra e paraqiti Adelina Sahiti, drejtore.

Të gjitha grupet parlamentare e përkrahën këtë propozimvendim për miratim

**Feim Osmani** kërkoi të dijë se ky propozim për ndihmës a ka ardhur nga familjet strehuese apo drejtoria përkatëse ka bërë hulumtim dhe ka gjetur vetëm këto dy raste. Në bazë të ligjit në fuqi, personat kur e kalojnë moshën 18 vjeçare dhe janë me aftësi të kufizuara, a i nënshtrohen menjëherë një ndihme tjetër, që është pension invalidor, apo mbesin pa asnjë të ardhur, si dhe nëse ka një plan strategjik drejtoria përkatëse që t'i hulumtoj rastet e tjera dhe t'i ndihmojë të gjitha familjet brenda territorit të Prishtinës që kanë në strehim fëmijë të kësaj kategorie?

**Violeta Salihu** pyeti se drejtoria a ka ndonjë plan strategjik se si kanë me qenë shërbimet shëndetësore, e që është një fakt shumë i rëndësishëm për sigurimin e barnave, pasi që në shumë raste shuma e ndarë për këta fëmijë nuk i mjafton familjes për të ia siguruar barnat të cilat ju kushtojnë shumë.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga parafolësit, sqarime shtesë dha Adelina Sahiti, drejtore.

**Kryesuesi** konstatoi se më 42 vota për dhe 1 kundër, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve për dy familje strehuese, të cilat përkujdesen për dy fëmijë me aftësi të kufizuara pa përkujdesje prindërore dhe familjare.

Faqe7nga12

## **Pika e njëmbëdhjetë**

### **Propozimvendimi për subvencionimin e familjeve për regjistrim të fëmijëve në institucionet parashkollore private;**

Lidhur me këtë propozimvendim të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Besianë Musmurati, drejtoare.

**Nora Kelmendi** tha se ne si Grup i LVV-së do ta përkrahim këtë iniciativë dhe shpresoj që kriteret nuk do të jenë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

**Lendita Rexhepi** tha se ne si grup parlamentar i LDK-së e mbështesim këtë propozimvendim dhe jemi të lumtur që për herë të parë Komuna e Prishtinës po i mbështet këto familje për regjistrimin e fëmijëve në institucionet parashkollore private.

**Leutrim Retkoceri** tha se me këtë iniciativë të ndërmarrë, është mirë që po preket në një sektor të ndjeshëm siç është familja dhe fëmijët. E mbështesim në plotëni dhe uroj që të shkojë mbarë implementimi i kësaj politike.

**Valbona Ajeti** tha se edhe ne si GP e mbështesim për miratim këtë propozimvendim.

**Gëzim Mehmeti** tha se është propozim i qëlluar ku theksohet ndihma e familjeve me nevoja të veçanta në këtë rast dhe çdo ndihmë është e mirëseardhur dhe do të ketë përkrahje për miratim.

**Endrit Zabërgja** tha se e përkrahim çdo vendim të tillë të cilët i mbështesin sidomos kategoritë sociale dhe në nevojë.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 41 vota për, u miratua Vendimi për subvencionimin e familjeve për regjistrim të fëmijëve në institucionet parashkollore private.**

## **Pika e dymbëdhjetë**

### **Informatë për procesin e mbajtjes së zgjedhjeve të Këshillave të Bashkësive Lokale.**

**Arianit Beqiri** kërkoi nga drejtori i Drejtorisë së Administratës, që të paraqesë një informatë rreth procesit të mbajtjes së zgjedhjeve të Këshillave të Bashkësive Lokale.

Lidhur me Informatën për procesin e mbajtjes së zgjedhjeve të Këshillave të Bashkësive Lokale, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Bersant Beka, drejtor.

**Feim Osmani**, në cilësinë e anëtarit të komisionit për zgjedhjen e Këshillave të Bashkësive Lokale, tha se jemi përballur me një sfidë të jashtëzakonshme, e që nëse Kuvendi konstaton se ne nuk kemi qenë të aftë me e bërë punën ashtu siç duhet, e ka kompetencën ta shkarkojë këtë komision dhe të gjejë rrugë tjetër për ta përfunduar këtë proces. Ne si komision ndoshta nuk e kemi vlerësuar mjaftueshëm politizimin e procesit, mirëpo që me fillimin e punës e kemi parë se është një proces jashtëzakonisht i politizuar në terren, ndoshta më shumë sesa në



komision. Tani jemi në një proces ku kemi arritur me i përfunduar vetëm gjysmën e takimeve të cilat i kemi planifikuar.

Sido qoftë, duke pasur parasysh gjendjen që është krijuar në terren, ndonjëherë edhe acarimet ndërmjet votueseve, propozoj që të shqyrtohet mundësia e ndërprerjes së këtij procesi në këtë fazë, ku kemi ankesa edhe të deponuara, e që komisioni duhet t'u japë përgjigje.

**Jeta Rafuna**, në cilësinë e anëtares së komisionit, tha se e kemi përgatitur një manual dhe besoj që tash e tutje do të kemi mbarëvajtje më të mirë të kuvendeve, mirëpo si komision kemi frymë të mirë të bashkëpunimit dhe ato që i tha parafolësi në fillim të seancës për blerje të votave, jo që nuk bën as me e diskutua, por kisha kërkuar të na kërkojnë falje, sepse po na ofendojnë të gjithëve.

**Leutrim Retkoceri**, në cilësinë e anëtarit të komisionit, fillimisht bëri vërejtje rreth komisionit, duke thënë se këshilli është zgjedhur pa kuotë gjinore, që është në kundërshtim me rregulloren, andaj ne duhet të kthehemi ta përmirësojmë atë kuvend në Hajvali.

Ky komision përbëhet pothuajse nga të gjitha partitë politike, por është shumë me rëndësi me e promovuar frymën e thirrjes së kandidatëve të cilët janë autoriteti më me ndikim në lagje, kështu që ne duhet ta krijojmë një klimë të hapur, ku kandidatët nuk do të jenë ata që përfaqësojnë subjektet politike, por ata që përfaqësojnë qytetarët edhe lagjet në lokalitete. Si PDK, kemi qenë të gatshëm me dhënë kontributin e plotë dhe mendoj se mund ta japim deri në fund.

**Valbona Ajeti**, në cilësinë e anëtares së komisionit, tha se në manualin e krijuar në të gjitha takimet që kemi pasur me kryesuesin dhe me drejtorin, ne komisioni e kemi cekur se cilët persona kanë të drejtë të marrin pjesë në këtë proces, i kemi mënjeluar njerëzit politikë, në këtë rast drejtorët e ndërmarrjeve, asamblistët, drejtorët e komunave etj., kështu që edhe unë jam për transparencë, jam për t'i raportuar çdo herë Kuvendit.

**Gëzim Mehmeti** theksoi se, siç po shihet nga raportimi i vetë pjesëtarëve të komisionit, vërehen parregullsi, do të thotë që do të merren masat rreth çështjes së mbarëvajtjes së rregullt bazuar në rregulloren. Andaj, kërkoj të dijë se sa do të zgjasë procesi dhe kur do të përfundojë.

**Gëzim Sveçla** tha se qëllimi i propozimit të grupit tonë për të diskutuar për këtë çështje rrjedh prej dy faktorëve. Faktori i parë është se jemi të njoftuar që ka parregullsi në këto kuvende zgjedhore dhe, e dyta është për të shikuar mundësinë që të njëjtat të eliminohen. Deri më tani janë mbajtur 9 këshilla lokale, mirëpo rezulton se nga këto 9 këshilla, në 5 prej tyre ka parregullsi, si në lagjet "Taslixhe", "Aktashi", "Arbëria" dhe "Hajvalia".

Lidhur me këtë proces, ai tha se vërehet ndikimi politik dhe kjo dihet shumë mirë, ndikimi ka filluar prej partisë në pushtet, prej LDK-së, kështu që ka probleme dhe do të ketë probleme tjera nëse vazhdojmë me këtë qasje.

**Arianit Beqiri** tha se nuk ka dyshim që ndikimi i drejtorëve të LDK-së në këtë proces është shumë i madh, kështu që LDK-ja është duke i marrë bashkësitë lokale për një arsye të vetme, që me e sabotuar punën edhe në ekzekutiv, andaj mendoj që këto këshillat e bashkësive lokale nuk e reprezentojnë realitetin në terren.

**Amir Simnica** tha se ne duhet t'ia besojmë punën këtij komisioni, diferencimi ose që një kandidat është i mirë brenda komisionit e të tjerët nuk janë të mirë, kjo është e rëndë për kulturën. Për lagjen "Aktashi" jam i thirrur edhe vetë të flas, sepse i takoj asaj zone, ku kam

marrë pjesë edhe unë, dhe tjetra mos t'i shikojmë drejtorët të cilët i takojnë asaj harte zonale për të votuar dhe mos të ndërlihet gjithçka me LDK-në.

**Endrit Zabërgja** u shpreh se duke pasur për bazë diskutimet rreth kësaj pike të rendit të ditës, kërkoj nga komisioni që raportimet me qenë më të rregullta, përderisa paska kaq shumë paqartësi dhe tendenca të ndryshme manipuluese, siç po quhen.

**Hafiz Krasniqi** theksoi se gjatë diskutimeve rreth kësaj teme, kamë vërejtur një fenomen që nuk po mundem as vet me e kuptuar. Të gjithë anëtarët e komisionit, varësisht prej partisë politike nga vijnë, asnjë koordinim nuk e kanë mes veti, edhe kjo për mua lë me kuptuar që diçka nuk është në rregull. Kemi të bëjmë me zgjedhjen e kryetarëve të bashkësive lokale, e jo për kryetar të partive politike, kështu që qytetarët e dinë, e njohin shumë më mirë se ne që jemi këtu se kush duhet të jetë ai personi që duhet të zgjidhët për kryetar të bashkësisë lokale.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha Bersant Beka, drejtor.

**U konstatua se u përkrahë Informata për procesin e mbajtjes së zgjedhjeve të Këshillave të Bashkësive Lokale.**

#### **Pika e trembëdhjetë**

**Raporti vjetor i punës për vitin 2022 i ndërmarrjes publike "Kuzhina Qendrore", SHA.**

Për Raportin vjetor të punës për vitin 2022 të ndërmarrjes publike "Kuzhina Qendrore", SHA, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Donat Lushaku, drejtor, njëherësh edhe në cilësinë e anëtarit të komisionit komunal të aksionarëve .

**U konstatua se u përkrah Raporti vjetor i punës për vitin 2022 i ndërmarrjes publike "Kuzhina Qendrore", SHA.**

#### **Pika e katërbëdhjetë**

**Raporti vjetor i punës për vitin 2022 i ndërmarrjes publike " Prishtina Parking", SHA.**

**Sami Salihu**, në cilësinë e anëtarit të komisionit komunal të aksionarëve, tha se duke marrë parasysh që nuk është informatë, por raport i punës së ndërmarrjes, raportimin për këtë ndërmarrje do ta paraqes Sokol Havolli, kryeshef ekzekutiv.

*GP i LVV-së në shenjë pakënaqësie nga paraqitja e raportit nga z. Havolli, kryeshef ekzekutiv, e lëshuan mbledhjen, me arsyetimin se për raportet e ndërmarrjeve publike lokale duhet të raportojnë anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve e jo kryeshefat ekzekutivë të ndërmarrjeve.*

Lidhur me Raportin vjetor të punës për vitin 2022 të ndërmarrjes publike " Prishtina Parking", SHA, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Sokol Havolli, kryeshef ekzekutiv.

**Sami Salihu**, kërkoi të dijë se a është ndërmarrë ndonjë hap në përmirësimin e gjendjes, pasi që ata punëtorë punojnë në kushte jo të mira.

Ai pyeti se çfarë është duke ndodhur me kontratën e sistemit apo të aplikacionit, si dhe a ka të drejtë që kjo ndërmarrje të operojë me bashkëpronësi, pasi që një çështje e tillë është përfolur nga LVV-ja, kinse "Prishtina Parking" nuk ka të drejtë të operojë.

**Endrit Zabërgja** tha se është më se e domosdoshme që ne t'i diskutojmë çështjet e rëndësishme mbi menaxhimin, e në veçanti vlen të theksohet çështja e aplikacionit, dhe nëse një kryeshef është shkarkuar për shkak të një aplikacioni dhe ai aplikacion vazhdon të mbetet pa u anuluar, cila është logjika e vazhdimin të mbetjes në fuqi. Po ashtu, mund të evidentohen vërejtje në përzgjedhjen e bordit, në rezervimin e parkingjeve, si dhe shumë parregullsi të tjera.

Ne jemi duke e shikuar gradualisht një tendencë, një thurje të secilës ndërmarrje dhe besoj që të gjithë ata asamblistë të cilët kanë vullnet për ta parë kryeqytetin në momente të tilla kur jemi duke e parë se çfarë po ndodh me ndërmarrjet, duhet të reflektojmë të gjithë së bashku.

**Lindita Rexhepi** tha se sa i përket zgjedhjes së bordit të kësaj ndërmarrjeje, e rëndësishme është se përzgjedhja e bordit të drejtorëve bëhet edhe me nënshkrimin e dy aksionarëve dhe procesi ecën pa asnjë pengesë, kjo është më se e ligjshme, nuk ka asgjë për me u shqetësuar që mungon nënshkrimi im në këtë proces.

**Elmira Nikqi – Rexha**, kërkoi të dijë se a është bërë ndarja e lagjeve në lidhje me lirimimin e pagesës nga vetura e parë për banorët rezidentë dhe a do të kompensohen ata qytetarë të cilët kanë paguar deri më tani.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha Sokol Havolli, kryeshef ekzekutiv.

**U konstatua se u përkrah Raporti vjetor i punës për vitin 2022 i ndërmarrjes publike "Prishtina Parking", SHA.**

**Pika e pesëmbëdhjetë**

**Raporti vjetor i punës për vitin 2022 i ndërmarrjes publike "Hortikultura", SHA.**

Për Raportin vjetor të punës për vitin 2022 të ndërmarrjes publike "Hortikultura", SHA, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Kumrije Shabani, anëtare e komisionit komunal të aksionarëve.

**Fiknete Bejta** e përgëzoi aksionaren, znj. Shabani, për raportimin e mirëfilltë për ndërmarrjen publike lokale "Hortikultura". Gjithashtu, e përgëzoi edhe menaxhmentin e ndërmarrjes që e kanë ndryshuar pamjen e kësaj ndërmarrjeje, ku dhe po shihen aktivitetet pozitive në qytetin e Prishtinës.

**U konstatua se u përkrah Raporti vjetor i punës për vitin 2022 i ndërmarrjes publike "Hortikultura", SHA.**

**Pika e gjashtëmbëdhjetë  
Pyetje dhe përgjigje.**

**Gëzim Mehmeti, për kryetarin e Komunës:**

- Në një diskutim që e kam pasur, kam theksuar që ka mungesë të transparencës në Komunën e Prishtinës, kështu që duhet që qytetarët e Prishtinës të jenë të vetëdijshëm dhe të kenë informata, se pse kjo rënie drastike për një vit për pesë vende.

**Arbnora Ajeti, njoftim për Kuvendin dhe ekzekutivin e Komunës:**

- Ne si komision i aksionarëve të ndërmarrjes "Hortikultura", në konsultim me kryetarin e Komunës dhe aksionarët, propozoj që të bëhet ndryshimi i emrit të ndërmarrjes nga NPL "Hortikultura" në NPL "Gjelbër", që i referohet qytetit të gjelbër.

**Granit Geci, për kryetarin e Komunës:**

- Deri ku ka mbërritur propozimi apo zotimi ynë i përbashkët si partnerë të koalicionit në Komunën e Prishtinës, për vendosjen e shtatores së heroit tonë Adem Jasharit. Mendoj se do të ishte korrekte ndaj qytetarëve të Prishtinës që ta kemi një përgjigje se a do ta kemi të paktën gjatë këtij viti, këtë 28 nëntor ta kemi kryeheroin tonë në kryeqytet.

**Sami Salihu, për kryetarin e Komunës:**

- Në lagjen "Dardania", konkretisht afër rrugës "Ilaz Kodra", te shkolla fillore "Xhemail Mustafa" dhe biblioteka, është një ndërtesë e cila qe 24 vjet nuk ka status. Banorët aty janë shumë të shqetësuar, sepse paguajnë taksa por nuk mund ta përkthejnë. A është ndërmarrë ndonjë iniciativë për këtë çështje, pasi që ka qenë edhe premtim i juaji për zgjidhjen e këtij problemi.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga parafolësit, përgjigje dhanë Përparim Rama, kryetar, dhe Krenar Xhaferi, drejtor.

*Mbledhja përfundoi në orën 15:50.*

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit  
Ajet Brajshori**



**Faqe12nga12**